



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.94 dt.03.07.1998

**“MBI
ÇELJEN E FONDEVE PER BLERJEN E DY AUTOBOTEVE TE
UJRAVE TE ZEZA, NJE FADROME DHE NJE AUTOBITUMATRIÇE”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.03.07.1998, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike e Shërbimeve (Drejtoria e Rrugë Kanalizimeve) “**Mbi çelje fondi për blerjen e dy autobotëve të ujrave të zeza, një fadromë dhe një autobitumatriçe**”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Lokal” si dhe ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”

V E N D O S I

1. Të çelet fondi prej **20 milion lekësh** për blerjen e dy autobotëve të ujrave të zeza.
2. Të çelet fondi prej **12 milion lekësh** për blerjen e një fadrome me disa atrecatura.
3. Të çelet fondi prej **8 milion lekësh** për blerjen e një autobitumatriçe.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve (Drejtoria e Rrugë Kanalizimeve) dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI